

# LAJMËRIM

РЕПУБЛИКА СРБИЈА  
REPUBLIKA E SËRBIË  
Гимназија-Гjimnazi  
"SKENDERBEU"

Бр.Нр. 227  
16.05.2023 год. Viti  
Прешево - Preshevë

## Orari i punës për kl.IV(për nxënës):

-Në bazë të kalendarit, mësimi për kl.IV në gjysmëvjetorin e dytë mbaron më **23.05.2023(e martë)**, mirëpo mësimi në gjuhën shqipe vazhdon deri më 26.05.2023(e premte) për arsye se duhet të kompenzohen ditët e realizimit të ekskursionit(03-05.05.2023).

-Mbledhja e këshillit të paraleleve të kl.IV mbahet më **26.05.2023(e premte)** duke filluar në orën **12<sup>00</sup>**. Në këtë mbledhje janë të obliguar të marrin pjesë përfaqësuesit e nxënësve.

-Komunikimi i suksesit dhe dhënia e dëftesave bëhet më **30.05.2023(e martë)** në orën **10<sup>00</sup>**.

-Paraqitja e provimit të maturës bëhet më **05-06.06.2023(e hënë-e martë)**, edhe ate:

**-05.06.2023(e hënë)** IV<sub>1</sub> -9<sup>30</sup>- 10<sup>00</sup>, IV<sub>2</sub> - 10<sup>30</sup>-11<sup>30</sup>, IV<sub>3</sub> -11<sup>30</sup>-12<sup>30</sup>, IV<sub>4</sub> -13<sup>30</sup>-14<sup>30</sup>

**-06.06.2023(e martë)**, IV<sub>5</sub> -10<sup>30</sup>-11<sup>30</sup>, IV<sub>6</sub> -11<sup>30</sup>-12<sup>30</sup>, IV<sub>7</sub> -12<sup>30</sup>-13<sup>30</sup>

(Paraqitja e provimit të maturës bëhet te sekretari i shkollës. Me rastin e paraqitjes së provimit të maturës, nxënësi duhet t'i sjellë këto dokumente: dëftesat prej kl.I-IV, kërkesën për paraqitjen e provimit të maturës-mirret te sekretari i shkollës, çertifikatën e lindjes-vazhdon e vjetra, tri kopje të punimit të maturës, ku duhet të figurojë data e dorëzimit dhe të nënshkruara nga ana e mentorit-profesorit të lëndës më së voni deri më 30.05.2023. Dokumentet duhet të jenë të vendosura në fasikël. Pa këto dokumente të lartpërmendura, provimi i maturës nuk mund të paraqitet).

-Provimi i maturës nga lënda e gjuhës shqipe (me shkrim) mbahet më **08.06.2023(e enjte)** duke filluar prej orës **9<sup>30</sup>-12<sup>00</sup>**.

-Provimi i maturës nga lënda e matematikës dhe gjuhëve të huaja (me shkrim) mbahet më **12.06.2023(e hënë)** duke filluar prej orës **9<sup>30</sup>-12<sup>00</sup>**.

**-Më 09.06.2023(e premte) mbahet mbrëmja e maturës në restorantin „ROMANSA” në Zhunicë, muzika MEFA me shoqërinë e vet (Më detalisht informoheni nga komisioni i kl.IV).**

-Mbrojtja e temës (punimit) së maturës mbahet prej **14-16.06.2023( e mërkurë-e premte)** prej orës **9<sup>30</sup>-15<sup>00</sup>**.

-Dorëzimi i diplomave bëhet më **20.06.2023(e martë)**. Kujdestarët e paraleleve vet e caktojnë kohën e dhënies së diplomave sipas mënyrës së njejtë të orarit të paraqitjes së provimit të maturës.

-Drejtorja e shkollës maturantëve iu dëshiron sukses në dhënien e provimit të maturës.

**V ë r e j t j e:** Nxënësve iu tërhiqet vërejtja që orarin e lart- shënuar ta respektojnë në tërësi në të kundërtën nuk mund t'iu nënshtrohen provimit të maturës. **Këtë lajmërim dhe informatat tjera mund t'i merrni nga web faqja e shkollës; [www.al.gjimnazi-skenderbeu.com](http://www.al.gjimnazi-skenderbeu.com)**

15.05.2023  
Preshevë.



Drejtori,

Nadër Sadiku